



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1398/23

GJYKATA E KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore, të kreditorit Crimson Financial Found LLC me seli në Prishtinë, ndaj debitorëve NPT Argo – Ramaj me adresë në fshatin Gurrakoc Komuna Istog dhe L.R. (pronar) nga fshati Gurrakoc Komuna Istog, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, PPP.nr.18/2022, të datës 31.05.2022, me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorëve NPT Argo – Ramaj dhe L.R. nga fshati Gurrakoc Komuna Istog, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë- Dega në Istog, PPP.nr.18/2022 i datës 31.05.2022, dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega Istog, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.18/2022, të datës 31.05.2022, e ka hedhur poshtë prapësimin e debitorëve NPT Argo – Ramaj me adresë në fshatin Gurrakoc Komuna Istog dhe L.R. nga fshati Gurrakoc-Istog, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.144/2022, datë 28.03.2022, si i pa afatshëm.

Kundër këtij aktvendimi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ankesë kanë parashtruar debitorët për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, me propozimin që të aprovohet në tërësi ankesa e debitorit dhe lënda PPP.nr.18/2022 t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Kreditori në përgjigjen në ankesë e konteston plotësisht si të pathemelt dhe të pabazuar ankesën e debitorit, duke i propozuar gjykatës që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar, ndërsa Aktvendimi PPP.nr.18/2022 i datës 31.05.2022 i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Istog dhe Urdhri për përmbarim P.nr.144/22 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se kreditori Crimson Financial Found LLC me seli në Prishtinë, me datën 28.03.2022, ka paraqitur propozim për përmbareim ndaj debitorëve NPT Argo – Ramaj me adresë në fshatin Gurrakoc K-Istog dhe L.R. nga Fsh Gurrakoc K-Istog, në bazë të dokumentit të besueshëm-Kontratës së Pengut të regjistruar në MTI, me të cilën ka kërkuar që të bllokohen llogaritë bankare të debitorit në RBKO 1506021001434083 dhe të konfiskohen mjetet financiare deri në shumë prej 12,104.18€, nga kjo llogari bankare dhe të barten në llogari të kreditorit.

Përmbareuesi Mehdi Reshani nga Prizreni duke vepruar sipas propozimit për përmbareim të kreditorit ka lejuar përmbareimin me urdhrin P.nr.144/22, të datës 28.03.2022, ndërsa kundër këtij urdhri debitorët kanë ushtruar prapësim datën 12.04.2022, ndërsa në bazë të dergeses postare që gjendet në shkresat e lëndës, urdhrin përmbareimor ndaj të cilit e ka paraqitur prapësimin e ka pranuar me datë 04.04.2022, në të cilin urdhër i është dhënë këshillë juridike se ndaj tij mund të ushtrojë prapësim në afat prej shtatë dite nga dita e pranimit.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori me datë 20.04.2022, me propozim që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorëve, ndërsa Urdhri për Përmbareim P.nr.144/2022 i datës 28.03.2022 të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve, fillimisht ka shqyrtuar afatshmërinë e prapësimit me çka edhe ka nxjerr aktvendimin e atakuar PPP.nr.18/2022, të datës 31.05.2022, me të cilin e ka hedhur poshtë si të pa afatshëm prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin përmbareimor P.nr.144/2022, të datës 28.03.2022. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se debitorët, urdhrin përmbareimor e kanë pranuar me datë 04.04.2022, ndërsa i autorizuari i debitorëve prapësimin e ka ushtruar me datë 12.04.2022, nga ku është konstatuar se debitorët nuk kanë vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapësimit kundër urdhrin për lejjimin e përmbareimit bazuar në nenin 70 të Ligjit për procedurën Përmbareimore.

Gjykata e Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 182.2 pika n), 183, 127 të LPK-së, e lidhur me nenin 29 paragrafi 1 pika 1.3 e lidhur me nenin 40 dhe 43 paragrafi 4 dhe 70 të LPP-së.

Gjykata e Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë nuk mund ta pranojë mënyrën e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të ankimuar për arsye se kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Gjykata e Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, nuk mund ta pranojë këtë qëndrim dhe përfundim të gjykatës së shkallës së parë, për faktin nga shkresat e lëndës vërtetohet se urdhrin për lejimin e përmbarimit debitorët e kanë pranuar me datë 04.04.2022, ndërsa prapësimin e kanë ushtruar nëpërmes postës, me datë 12.04.2022, i cili konsiderohet si dorëzim i rregullt i prapësimin në kuptim të dispozitës së neni 127 paragrafi 2 të LPK-së dhe i njëjti është i afatshëm në kuptim të dispozitës së nenit 70 të LPP-së, pasi që është parashtruar brenda afatit prej 7 ditësh, gjegjësisht është pranuar në ditën e shtatë, për faktin se data 11.04.2022 si ditë e fundit për dorëzimin e prapësimin në kalendarin e festave zyrtare të Republikës së Kosovës ka qenë ditë pushimi, andaj edhe një qëndrim dhe përfundim juridik i gjykatës së shkallës së parë është jo i drejtë dhe i ligjshëm, andaj edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë kompetente.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të vlerësoj shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, duke vendosur në mënyrë meritore lidhur me prapësimin e debitorëve, e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

## GJYKATA E KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1398/23 datë 04.06.2024

Gjyqtari  
Krenar Berisha